



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 84-të, të mbajtur më 31.03.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-1093/1 të datës 18.02.2022, me pretendimet për mjete të paguara të këshillave zgjedhorë dhe Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Komunë ///, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se në pajtim me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për verim kompetent për rastin e lëndës.

Lënda me numër 12-1093/1 të datës 18.02.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më 18 shkurt 2022, një parashtrues i njohur ka dorëzuar denoncim me pretendime për fonde të paguara në këshillat zgjedhorë dhe Komisionin Komunal të Zgjedhjeve në Komunë /// dhe është formuar lënda me numër 12-1093/1 e datës 18 shkurt 2022.

Në denoncim, parashtruesi thekson se përkundër faktit se në Buxhetin e Komunës për vitin 2021 janë paraparë mjete në vlerë prej 2 milionë denarë, këshillat zgjedhorë dhe Komisioni komunal i zgjedhjeve në Komunën e ///, deri në ditën e dorëzimit të denoncimit në KSHPK, nuk janë paguar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arrin në përfundimin se pretendimet e denoncuar në këtë rast nuk janë në juridiksionin e KSHPK-së.

Rrjedhimisht, KSHPK-ja konsideroi se nuk kishte elemente për veprime të metutjeshme, pas së cilës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:
- parashtruesi i denoncimit

Përpiloi: A.R.M.
Miratoi: Mr. V.G, anëtar i KSHPK-së

**КОМИСИОН ШТЕТЁРОР
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ**
Нёнкрыетар,
Катика Николовска

